

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

KUVENDI I SHQIPËRISË



MIRATOHEN NDRYSHIMET KUSHTETUESE PËR ZGJATJEN E MANDATIT TË ORGANEVE TË VETTINGUT

Në seancën parlamentare të dates 10 shkurt 2022 me konsensus të plotë u miratua zgjatja e mandatit të Institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve konkretisht të Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit dhe Komisionerëve publikë deri në 31 dhjetor 2024. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



INTERPELANCË E MINISTRIT TË DREJTËSISË LIDHUR ME TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË IEVP-VE

Në interpelancën e kërkuar nga deputeti Piroli, më 3 shkurt 2022, Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja pasqyroi mënyrën e trajtimit të punonjësve të IEVP-ve duke theksuar reformën e thellë që është ndërmarrë në sistemin penitenciar si dhe përafrimin e sistemit të karrierës së policisë së burgjeve me sistemin e karrierës dhe trajtimin financiar të policisë së shtetit. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT ME MINISTRINË E DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE TË KROACISË

Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja priti homologun e tij kroat, ministrin Ivan Malenica në datat 22-23 shkurt 2022. Gjatë bisedimeve të të dy ministrave të drejtësisë, pala kroate u angazhua në asistimin e Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare në procesin e hapjes së negociatave, sidomos fokusuar në kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", duke krijuar grupe pune të përbashkta dhe shkëmbyer eksperiencat më të mira në fushën e integritit si dhe në luftën kundër korrupsionit. Në përfundim të kësaj vizite dy ministrat nënshkruan një memorandum bashkëpunimi i cili pritet të konkretizohet me krijimin e grupeve të përbashkëta të punës. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

REFORMA NË DREJTËSI



AMBASADORJA AMERIKANE TAKIM ME MINISTRIN E DREJTËSISË "NJERËZIT MERITOJNË REZULTATE TË VËRTETA NGA REFORMA NË DREJTËSI"

Muaji shkurt filloi me një takim të Ministrit Manja dhe Ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Yuri Kim kushtuar progresit dhe sfidave të reformës në Drejtësi. Ambasadorja Kim shprehu dhe njehere mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për reformën në drejtësi dhe u shpreh se tanimë priten rezultatet e vërteta nga kjo reformë. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



FORCOHET BASHKËPUNIMI ME MBRETËRINË E SPANJËS NË FUSHËN PENALE

Kuvendi i Shqipërisë në seancën e dates 17 shkurt ratifikoi marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin të vitit 1957" duke eliminuar pengesën ligjore që ka të bëjë me rezervën ligjore, duke lejuar autoritetet tona gjyqësore të kryejnë ekstradimin reciprok të shtetasve shqiptarë në drejtim të Spanjës dhe anasjelltas. [LEXO PËR MË SHUMË](#)

ANTIKORRUPSIONI



Në vazhden e plotësimit të rrjetit të koordinatorëve antikorruption dhe hetimit të çdo rasti abuziv me pagesat e pensioneve dhe jo vetëm, tanimë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Postës Shqiptare ka koordinatoren e saj, znj. Laureta Omeri të prezantuar nga Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja së bashku me Ministren e Infrastrukturës dhe Energjitikës znj. Belinda Balluku. [LEXO PËR MË SHUMË](#)



ORGANIZOHET TAKIMI I PARË KOORDINUES ME DONATORËT FOKUSUAR NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Një takim me donatorë, partnerë ndërkombëtarë dhe ekspertë të fushës është drejtuar nga Ministri i Drejtësisë dhe njëkohësisht Koordinatori Kombëtar Antikorruption. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i punës së deri më tanishme të DPA-së si dhe koordinimi i asistencës së huaj në fushën e antikorruptionit. Ky takim do të pasohet nga takime koordinuese me secilin donator për konkretizimin e nismave të përbashkëta. [LEXO PËR MË SHUMË](#)